

VENDIM
Nr. 296, datë 28.5.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË KRITEREVE PËR
ADMINISTRIMIN E FONDIT TË VEÇANTË TË BUXHETIT TË POLICISË SË
SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 138, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave e të kriterëve për administrimin e fondit të veçantë të buxhetit të Policisë së Shtetit nga drejtuesi i njësisë shpenzuese.

Neni 2

Fondi i veçantë

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit ndan fondin e veçantë, i cili është në maksimum sa 1% e buxhetit vjetor të Policisë së Shtetit, sipas nevojave që kanë strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit.

Neni 3

Përdorimi i fondit të veçantë

Policia e Shtetit përdor fondin e veçantë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 138, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”.

Pagesat jepen pas realizimit të veprimit policor konkret dhe marrjes së rezultatit ose në bazë të një planifikimi paraprak për realizimin e aktiviteteve policore ku parashikohen shpenzime operationale.

Ndalohet dhënia e shpërblimeve më shumë se një herë, të njëjtut burim, për të njëjtin rezultat konkret.

II. RREGULLAT DHE KRITERET E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË VEÇANTË

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve

1. Shefi i Komisarariatit të Policisë autorizon përdorimin deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

2. Zëvendësdrejtori për Hetimin e Krimeve/për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë, autorizon përdorimin deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

3. Drejtori i strukturës vendore të policisë/drejtuesi i sektorit për hetimin e krimeve në drejtorinë qendrore dhe drejtuesi i sektorit dhe zëvendësdrejtor në Drejtorinë e Antiterrorit autorizojnë përdorimin deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

4. Drejtori i Strukturës Qendrore për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, autorizon përdorimin deri në 1 000 000 (një milion) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

5. Drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale, drejtori i Departamentit për Sigurinë Publike dhe drejtori i Drejtorisë së Antiterrorit autorizojnë përdorimin e deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit autorizon përdorimin e mbi 5 000 000 (pesë milionë) lekë ose vlerën ekuivalente në valutë.

7. Nuk mund të autorizohet përdorimi i fondit të veçantë përtej fondit limit të përcaktuar në buxhetin për strukturën policore përkatëse. Në rastet kur nevojat janë përtej fondit limit të përcaktuar, kërkohet miratim nga eprori që ka kompetencë dhënien e autorizimit të përdorimit ose shtesë buxheti në fondin e veçantë.

8. Në rastet kur strukturë autorizuese sipas këtij neni nuk është drejtuesi i njësisë shpenzuese, në çdo rast kërkohet miratimi i këtij të fundit.

9. Kur gjatë përdorimit të fondit të veçantë, dinamika kërkon fonde të tjera, përtej atyre të miratuara, autorizohen fonde shtesë, me kusht që shuma e të gjitha rasteve të miratuara për përdorim të fondit të veçantë të mos kapërcejë kompetencën e autoritetit policor që jep autorizimin e përdorimit.

Neni 5

Procedura e planifikimit të fondit të veçantë

Planifikimi i fondit të veçantë kryhet, si më poshtë vijon:

1. Brenda tremujorit të parë të vitit, drejtoritë qendrore për hetimin e krimeve, drejtoritë vendore të policisë dhe komisaritet e policisë, si dhe Drejtoria e Antiterrorit dërgojnë në sektorin e arkivit kriminal, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivit Kriminal, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kërkesat për t'u buxhetuar me fond të veçantë për vitin pasardhës, duke i ndarë në tremujorë.

2. Brenda afatit të përgatitjes së projektbuxhetit të Policisë së Shtetit (PBA) për vitin pasardhës, sektori i arkivit kriminal, në Drejtorinë e Inteligjencës dhe Arkivit Kriminal, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bazuar në kërkesat e strukturave, përgatit të ndarë në tremujorë parashikimin e buxhetimit me fond të veçantë për vitin pasardhës dhe e dërgon në Drejtorinë e Financave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për procedurë.

3. Pas miratimit të fondit të veçantë, Drejtoria e Financave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në fillim të vitit buxhetor dërgon planin e përdorimit sipas përkatësisë.

4. Pjesë e buxhetimit në fondin e veçantë është edhe shuma prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, që mbahet gjendje në mënyrë të vazhdueshme në sektorin e financave për aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

5. Llogaria e fondit të veçantë në strukturat vendore të policisë mbahet nga sektori/seksioni i financave, ndërsa, në nivel qendror, nga sektori i financave për aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

6. Në rastin e situatave të rënduara kriminale dhe/ose për realizimin e operacioneve të veçanta policore të paplanifikuara, kur mjetet financiare në dispozicion janë shpenzuar apo nuk mjaftojnë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i propozon ministrit të Brendshëm buxhet shtesë për fondin e veçantë, pa tejkaluar, në çdo rast, kufirin prej 1% të buxhetit vjetor të Policisë së Shtetit.

Neni 6

Dokumentet që përpilohen për përdorimin e fondit të veçantë

Dokumentet që përpilohen për përdorimin e fondit të veçantë janë:

1. Vendimi për përdorimin e fondit të veçantë:

a) që përpilohet nga specialisti i policisë për krimet/hetimin e krimeve, në drejtoritë qendrore apo drejtoritë vendore e komisariatet e policisë, i cili do të realizojë veprimin konkret policor. Vendimi miratohet nga eprori në linjë vertikale sipas hierarkisë, por, në çdo rast, duke respektuar funksionin që ka të drejtë të autorizojë përdorimin e shumës konkrete të fondit të veçantë;

b) për shpërblimin e informatorit që përmban numrin kodik të informatorit, arsyen e shpërblimit, dosjen ku administrohet e dhëna/informata, rezultatin e arritur, shumën e parave;

c) për shpërblimin e burimit konfidencial, burimit të veçantë dhe personit që i përgjigjet thirrjes së policisë për informacion/ndihmë, që përmban gjenealogjetet e plota dhe adresën, dosjen ku administrohet informacioni, arsyen e shpërblimit, rezultatin e arritur, shumën e parave;

Vendimi për shpërblim përpilohet në një kopje të vetme sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, i cili protokollohet dhe administrohet në seksionin/sektorin e arkivit kriminal.

2. Vendimi për pagesat që kryhen nga fondi i veçantë, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi, që duhet të përmbajë:

a) situatën kriminale dhe rezultatin që synohet të arrihet;

b) qëllimin e shpenzimeve;

c) numrin dhe datën e procedimit penal, si dhe numrin e datën e autorizimit të prokurorit, për rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, kur ka procedim penal të regjistruar;

ç) sasinë e parave që do të shpenzohen për ushqim, fjetje, transport, karburant, ndërlidhje, qiramarrje mjedisi/ambienti/automjeti, si dhe shpenzime të tjera në funksion të realizimit të detyrave funksionale të punonjësit, me qëllim arritjen e rezultatit që synohet.

d) dosjen apo fashikullin ku administrohet praktika shkresore për zhvillimin e operacionit të veçantë policor.

Shpenzimet e kryera sipas shkronjës “ç” justifikohen me dokumentet përkatëse, që i bashkëlidhen dëftesës së pagimit. Në pamundësi për t’i siguruar këto dokumente, drejtuesi i operacionit të veçantë policor vërteton shpenzimet e kryera në relacionin shpjegues.

Vendimi për pagesë përpilohet në një kopje të vetme, i cili protokollohet dhe administrohet në seksionin/sektorin e arkivit kriminal.

3. Urdhërpagimi, që shërben për të realizuar tërheqjen e shumës së parave, sipas lidhjes nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi,:

a) përpilohet në dy kopje, nga të cilat njëra qëndron në sektorin/seksionin e financave dhe tjetra i bashkëlidhet vendimit për pagesë;

b) plotësohet nga specialisti për krimet/hetimin e krimeve, firmoset nga eprorët sipas shkallës hierarkike dhe urdhërdhënësi, merr numrin e protokollit të vendimit për pagesë dhe vuloset në sekretari/protokollin e strukturës policore përkatëse;

c) nënshkruhet edhe nga shefi i sektorit/seksionit të financave, përpara se të kryhen veprimet me arkën.

4. Dëftesa e pagimit, që është dokumenti që shërben për pasqyrimin e veprimit të marrjes së parave nga personi, i cili trajtohet financiarisht nga fondi i veçantë, sipas lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

a) Dëftesa e pagimit të shpenzimeve për kryerjen e operacioneve të veçanta policore nënshkruhet nga specialisti i policisë për hetimin e krimeve që ka përgjegjësinë për realizimin e veprimit policor dhe eprori i drejtpërdrejtë.

b) Në mungesë të eprorit të drejtpërdrejtë, dëftesa e pagimit nënshkruhet nga një epror në shkallë më të lartë hierarkike, brenda strukturës ku bën pjesë specialisti i policisë që kryen veprimin policor.

c) Dëftesa e pagimit për shpërblim të burimeve të informacionit nënshkruhet nga personi konkret që trajtohet nga fondi i veçantë, specialisti i policisë i ngarkuar për të kryer veprimin, eprori i drejtpërdrejtë apo punonjësi i autorizuar që asiston veprimin.

ç) Përgjigjetimi, në rastet kur personi, që trajtohet nga fondi i veçantë, është informator i regjistruar, ky i fundit vendos në dëftesën e pagimit numrin kodik dhe firmos.

d) Në rastet e shpërblimit të burimeve të informacionit deri në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, dëftesa e pagimit nënshkruhet nga personi konkret që trajtohet nga fondi i veçantë dhe specialisti i policisë i ngarkuar për të kryer veprimin.

dh) Në rastet vijuese të shpërblimit të njëjtë burim të informacionit, dëftesa e pagimit nënshkruhet nga personi konkret që trajtohet nga fondi i veçantë, specialisti i policisë i ngarkuar për të kryer veprimin dhe punonjësi i autorizuar prej urdhërdhënësit për përdorimin e fondit të veçantë.

e) Dëftesa e pagimit plotësohet në një kopje dhe i bashkëlidhet vendimit për pagesë.

5. Relacioni shpjegues, që është dokumenti që përpilohet nga specialisti i policisë për të vërtetuar shpenzimet e kryera, sipas lidhjes nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi. Relacioni përpilohet nga specialisti i policisë për të vërtetuar shpenzimet e kryera, firmoset sipas shkallës hierarkike dhe miratohet nga drejtuesi i operacionit të veçantë policor. Relacioni shpjegues plotësohet në një kopje dhe i bashkëlidhet vendimit për pagesë.

6. Dëftesa përfundimtare, sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që është dokumenti që vërteton shpenzimin e shumës së parave sipas qëllimit të përcaktuar. Dëftesa firmoset nga specialisti që ka bërë pagesën, sipas shkallës hierarkike dhe nga urdhërdhënësi. Dëftesa përfundimtare përpilohet në një kopje dhe dorëzohet në seksionin/sektorin e financave nga specialisti i policisë për hetimin e krimeve, që ka realizuar tërheqjen e parave.

7. Mandatpagesa, që është dokumenti që plotësohet nga përfaqësuesi i seksionit/sektorit të financave, pas marrjes së dëftesës përfundimtare. Ky dokument plotësohet në tri kopje, ku dy kopje qëndrojnë në seksionin/sektorin e financave dhe një kopje e merr specialisti që ka bërë tërheqjen e parave, e cila i bashkëlidhet vendimit për shpërblim/pagesë.

8. Autorizimi për asistuesin, sipas lidhjes nr. 7, bashkëlidhur këtij vendimi, që përpilohet në të gjitha rastet kur shpërblehen burime të informacionit policor, me mbi 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, me të cilin punonjësi i policisë që kryen veprimin asistohet nga një punonjës i autorizuar nga urdhërdhënësi për përdorimin e fondit të veçantë. Autorizimi për punonjës të policisë, që asiston veprimin, përpilohet në një kopje, e cila i bashkëlidhet vendimit për shpërblim.

Neni 7

Autoriteti urdhërdhënës për kryerjen e veprimit financiar

Autoritetet urdhërdhënëse për kryerjen e veprimit financiar janë, si më poshtë vijon:

1. Drejtuesi i strukturës vendore të policisë, si nëpunësi autorizues në njësinë shpenzuese.
2. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, si nëpunësi autorizues i programit Policia e Shtetit;
3. Autoriteti urdhërdhënës për rastet e shpërblimit të burimit të veçantë dhe personit që i përgjigjet thirrjes së policisë për informacion/ndihmë, në çdo rast është drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 8

Administrimi i dokumentacionit për fondin e veçantë

1. Procedura e administrimit të dokumentacionit për përdorimin e fondit të veçantë është, si më poshtë vijon:

a) Vendimi për pagesë, një kopje e urdhërpagimit, dëftesa e pagimit dhe mandatpagesa dorëzohen në sektorin/seksionin e arkivit kriminal nga specialisti përkatës për hetimin e krimeve.

b) Praktikës i bashkëlidhen dhe autorizimi për asistuesin, relacioni për vërtetimin e shpenzimeve në operacionet e veçanta policore, dokumentacioni i justifikimit të shpenzimeve në operacionet e veçanta policore, dokumenti i konvertimit të lekëve në valutë të huaj.

c) Specialisti/shefi i sektorit/seksionit të arkivit kriminal bën regjistrimin e tyre si një praktikë e vetme në regjistrin model-7, sipas numrit kronologjik dhe këto dokumente mbahen të ndara sipas viteve.

c) Dokumentet e krijuara mbyllen në zarfe dhe ruhen në arkivin kriminal, sipas afateve të përcaktuara në aktin normativ përkatës.

d) Veprimet për evidentimin e përdorimit të fondit të veçantë kryhen në arkivin kriminal në nivel qendror dhe vendor, pjesë e strukturës së autorizuesit të veprimit, apo kartotekën ku evidentojnë veprimtarinë gjurmuese policore (*Antiterrori*).

dh) Në strukturat policore, që nuk janë njësi shpenzuese, veprimet do të evidentohen dhe do të administrohen në sektorin/seksionin e arkivit kriminal, në drejtorinë vendore të policisë, sipas juridiksionit.

e) Një kopje e urdhërpagimit, dëftesës përfundimtare dhe një kopje e mandatpagesës qëndrojnë në seksionin/sektorin e financës dhe iu nënshtrohen rregullave financiare.

ë) Punonjësi i policisë, nga koha që ka tërhequr paratë në strukturat e financës, duhet të mbyllë praktikën në këto afate:

i. brenda 20 (njëzet) ditëve në rastet e dhënies së shpërblimeve;

ii. brenda 3 (tre) muajve, në rastet e përdorimit të fondit të veçantë për shpenzime gjatë kryerjes së operacioneve të veçanta policore.

f) Në rastet e mosmbylljes së veprimeve me financën dhe arkivin kriminal brenda afatit tremujor, për shkak të shtrirjes në kohë të operacionit të veçantë policor, përtej këtij afati, vonesa motivohet në relacionin shpjegues dhe në dëftesën përfundimtare. Në çdo rast, veprimet duhet të mbyllen brenda një muaji nga përfundimi i operacionit të veçantë policor.

g) Kur burimet e informacionit policor nuk pranojnë të marrin shpërblimin apo paratë e tërhequra për kryerjen e operacionit të veçantë policor nuk përdoren, ato kthehen menjëherë në financë. Në këtë rast, specialisti i policisë përpilon një relacion shpjegues, të cilin bashkë me mandatar-këtimin e shumës së lekëve ia bashkëlidh vendimit të shpërblimit. Relacioni nënshkruhet edhe nga eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit të policisë.

2. Dokumentet e përpiluara dhe praktika e krijuar për përdorimin e fondit të veçantë klasifikohen “Tepër sekret” dhe trajtohen sipas ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Udhëzimi nr. 683, datë 25.11.2019, i ministrit të Brendshëm, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për përdorimin e fondit të veçantë”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
(Struktura përkatëse)

MIRATOHET

“Tepër sekret”

Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet

Kopje e vetme

(Vendoset funksioni që ka kompetencën)

Grada, Emri, Mbiemri

_____, më _____.

VENDIM

Nr. _____, datë _____.

Për shpërblimin e Informatorit TR-143/burimi konfidencial/burim i veçantë/personit që i përgjigjet thirrjes policisë / _____ lekë/valutë e huaj.

(me shifra dhe me shkrim)

Në _____, më datë _____, unë, _____ me detyrë _____,

(grada, emri, mbiemri)

në drejtorin/komisariatit të policisë _____, pasi studiova të dhënën/informacionin e marrë nga informatori xx-xxx/burimi konfidencial/burimi i veçantë/burimi konfidencial/personi që i përgjigjet thirrjes së policisë, të administruar në dosjen e informatorit/dosjen e procedimit policor nr. _____, datë _____:

Konstatova:

Se informatori TR-143/personi i identifikuar/burimi i veçantë/burimi konfidencial ka informuar me datë _____ se shtetasi/shtetasit _____,

(Shënohen emrat e personave të implikuar dhe banimi i tyre)

të cilët erren/kryejnë _____ duke bashkëpunuar edhe me _____.

(Në këtë pjesë përshkruhet shkurtimisht e dhëna/informacioni, vepra/t penale që kryen/kryejnë personat që implikohen, bashkëpunetorët etj., si dhe të dhëna të tjera që shohin të arsyeshme)

Me qëllim që (përshkruhet arsyeja e shpërblimit, rezultati i arritur, ose që pritët të arrihet) mbështetur dhe në Vendimin Nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave, kreu _____, pika _____, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për administrimin e Fondit të Veçantë”

Vendosa:

Që informatori, xx-xxx/personit të identifikuar/burimit të veçantë/ burimit konfidencial, për përballimin e shpenzimeve/ si shpërblim për rezultatin e arritur t’i japë shumën (_____) lekë/valutë e huaj.

(me shifra dhe me shkrim)

Specialisti

Eprori direkt

(grada, emri, mbiemri)

(grada, emri, mbiemri)

Shefi Sektorit

(grada, emri, mbiemri)

Shënim: Vendimi për pagesa bëhet për rastet e përdorimit të fondit të veçantë të parashikuara në Vendimin Nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave, duke argumentuar arsyen dhe rezultatin konkret që është arritur/pritet të arrihet dhe duke krijuar të gjitha dokumentet e nevojshme të përcaktuara në vendim. Vendimi nënshkruhet sipas varësisë dhe hierarkisë.

TEPËR SEKRET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

(Struktura përkatëse)

MIRATOHET

“Tepër sekret”

Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet

Kopje e vetme

Vendoset funksioni qe ka kompetencen

Grada, Emri, Mbiemri

_____, më _____, _____.

VENDIM

Nr. _____, datë _____.

Për pagesën me _____ lekë/valutë e huaj për operacionin e veçantë policor

(me shifra dhe me shkrim)

Në _____, më datë _____, unë, _____ me detyrë _____,
(grada, emri, mbiemri)

në drejtorinë/komisariatën e policisë _____, pasi studiova të dhënat/informacionet e marrë nga informatori xx-xxx / (burimet e tjera), të administruara në dosjen e procedimit/ drejtimit/përqendruar nr. _____, datë _____, _____:

Konstatova:

Se informatori xx-xxx/ (burimet e tjera), ka informuar më datë _____ se shtetasi/shtetasit _____ të cilët merren/kryejnë _____

(Shënohen emrat e personave të implikuar dhe vendbanimi i tyre)

duke bashkëpunuar edhe me _____.

(Në këtë pjesë përshkruhet shkurtimisht e dhëna/informacioni, vepra/t penale që kryen/kryejnë personat që implikohen, bashkëpunëtorët, autorizimi i prokurorit për kryerjen e veprimeve simuluese etj., si dhe të dhëna të tjera që shihen të arsyeshme)

Me qëllim përballimin e shpenzimeve në operacionin e veçantë policor për (përshkruhet shkurt operacioni special dhe rezultati që synohet të arrihet në këtë operacion), do të përdoren sasia e lekëve _____ (Në këtë pjesë përshkruhet qëllimi dhe sasia e lekëve që parashikohet të shpenzohen për : 1. ushqim; 2. Fjetje; 3. Transport; ndërlidhje etj.)

Për sa sipër, mbështetur në, pika _____, germa _____, të vendimit nr. _____, datë _____ “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për administrimin e Fondit të Veçantë”,

Vendosa:

Që _____, me detyrë _____, në drejtorinë/komisariatën, _____,
(grada, emri, mbiemri)

për përballimin e shpenzimeve t'i japë shumën _____ lekë/valutë e huaj.

(me shifra dhe me shkrim)

Specialisti

(grada, emri, mbiemri)

Eprori direkt

(grada, emri, mbiemri)

Shefi Sektorit

(grada, emri, mbiemri)

Shënim: Vendimi për pagesa bëhet për rastet e përdorimit të fondit të veçantë të parashikuara në vendim, duke argumentuar arsyen dhe rezultatin konkret që është arritur/pritur të arrihet dhe duke krijuar të gjitha dokumentet e nevojshme të përcaktuara në vendim. Vendimi nënshkruhet sipas varësisë dhe hierarkike.

TEPËR SEKRET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
Struktura përkatëse

“Tepër sekret”

Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet

Kopje Nr _____

_____ .më _____ . _____ . _____

URDHËR - PAGIMI

Nr. _____ Datë _____ . _____ . _____
(vendoset numri dhe data e vendimit për shpërblim/pagesë)

Në zbatim të Vendimit Nr. _____, datë _____, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për administrimin e Fondit të Veçantë”, të kryeni pagesë paradhënie për shpërblim/pagesë nga Fondi i Veçantë Z. _____, me detyrë _____, në drejtorinë/komisariatën e policisë _____, për shumën _____ lekë/valutë e huaj.

(me shifra dhe me shkrim)

Specialisti për hetimin e krimeve

(Grada, emër, mbiemër, firmë)

Eprori Direkt

(Grada, emër, mbiemër, firmë)

Shefi Sektorit

(Grada emër, mbiemër firmë)

Zv.Drejtori i Policisë

(Grada, detyra, emër, mbiemër, firmë)

Urdhër dhënësi

(Grada, emër, mbiemër, firma dhe vula)

Shënim: Urdhri i pagimit plotësohet mbasi të jetë miratuar vendimi dhe firmoset nga specialisti për hetimin e krimeve që do të tërheqë lekët në financë, eprori direkt dhe eprorët e tjerë sipas shkallës së hierarkisë, dhe në çdo rast urdhër dhënësi.

TEPËR SEKRET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETËTIT
Struktura përkatëse

“Tepër sekret”

Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet

Kopje e vetme

_____ më, ____ - ____ - ____

DËFTESË – PAGIMI

Nr. _____, Datë ____ - ____ - ____

Shuma prej _____ lekë/valutë e huaj ju dhanë
(me shifra dhe me shkrim)

_____, prej meje specialistit për hetimin e
krimeve, _____, në prezencë të _____

Arsyeja e dhënies:

Marrësi i lekëve

Paguesi

(Emër mbiemër firmë)

(Grada, emër, mbiemër, firma)

Asistuesi

(Grada, funksioni, emri, mbiemri, firma)

Shënim: Informatorët nënshkruajnë duke vendosur pseudonimin dhe firmën, ndërsa për burimet e tjera të informacionit nënshkruajnë duke vendosur emër, mbiemër dhe firmë nga personi konkret që trajtohet nga Fondi Veçantë.

TEPER SEKRET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHITETIT
Struktura përkatëse

“Tepër Sekret”
Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet
Kopje e vetme

Nr. _____ . Prot.

_____, më ____ . ____ .20 ____

DËFTESË PËRFUNDIMTARE

Vërtetohet se shuma prej _____ lekë u shpenzuan për operacionin e veçantë
(me shifra dhe me shkrim)
policor/shpërblim të burimeve të informacionit, nga Fondi i Veçantë, sipas vendimit
nr. _____, datë ____ . ____ .20 ____

Specialisti për hetimin e krimeve

Eprori Direkt

(Grada, emër, mbiemër, firmë)

(Grada, emër, mbiemër, firmë)

Shefi Sektorit
(Grada emër, mbiemër firmë)

Zv.Drejtori Policisë

(Grada, detyra, emër, mbiemër, firmë)

Urdhër dhënësi

(Grada, emër, mbiemër, firma dhe vula)

Shënim: Në asnjë rast në dëftesën përfundimtare nuk do të shkruhen gjeneralitetet apo të dhëna të tjera identifikuese të personit që është shpërblyer/paguar apo të dhëna të tjera identifikuese për operacionin e veçantë policor. Dëftesa përfundimtare plotësohet mbasi të jetë shpërblyer/paguar burimi informacionit policor apo të ketë përfunduar operacioni i veçantë policor, firmoset nga specialisti për hetimin e krimeve që ka tërhequr lekët në financë, eprori direkt dhe eprorët e tjerë sipas shkallës së hierarkisë, dhe në çdo rast urdhër dhënësi.

TEPER SEKRET

Lidhja 6
"Tepër Sekret"
Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet
Kopje e vetme
Tiranë, më _____._____.

Relacion

Për vërtetimin e shpenzimeve të kryera në operacionin special,
sipas vendimit nr. _____, datë _____._____.

Në _____, më datë _____._____._____, unë _____
(grada, emri, mbiemri)

me detyrë _____, në drejtorinë (vendore/qendrore), pas përfundimit
të operacionit special miratuar me planin operacional nr. _____, datë _____, me qëllim
justifikimin e shpenzimeve të shumave të tërhequra me vendim nr. _____,
datë _____._____._____.

Vërtetohet:

Shuma e lekëve të harxhuara, që për arsye të mosdekonspirimit të operacionit nuk janë
justifikuar me dokumentacionin bashkëlidhur dëftesës së pagimit, janë shpenzuar si më
poshtë:

Nr.	Lloji i shpenzimit	Sasia e lekëve/eurove		Emri, mbiemri (personi që ka shpenzuar lekët/eurot)	Firma
		Me shifra	Me shkrim		
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
Totali					

Nga shuma _____ e tërhequr u shpenzuan _____ lekë/euro ndërsa
shuma prej _____ lekë/euro, për arsye se _____
u kthye në arkën e financës.

Personi që ka bërë shpenzimet

(grada, emri, mbiemri)

Drejtuesi i operacionit

(grada, emri, mbiemri)

Dakort

Drejtori i drejtorisë (vendore/qendrore)

(grada, emri, mbiemri)

Shënim: ky relacion përpilohet në një kopje të vetme dhe i bashkëngjitet dëftesë së pagimit, bashkë me dokumentet e tjera që justifikojnë shpenzimet e kryera.

TEPER SEKRET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
Struktura përkatëse

AUTORIZIM

Tepër Sekret
Afati i ruajtjes së klasifikimit: 30 vjet
Kopje e vetme
_____, më ____ . ____ .20 ____

Autorizohet _____, me detyrë _____
(Grada, emër, mbiemër) (shef sektori/seksioni, specialist)
në _____, të _____,
(Sektori/seksioni) (drejtoria qendrore/vendore/komisariati policisë)
të asistojë në dhënien e shumës prej _____ lekë/euro të:
(me shifra dhe me shkrim)
nga _____, me detyrë _____,
(Grada, emër, mbiemër) (shef sektori/seksioni, specialist)
në drejtorinë _____ /komisariatit e policisë _____, sipas
vendimit nr. _____, datë ____ . ____ . ____.

Urdhër dhënësi

(Grada, emër, mbiemër, firma dhe vula)

(Sektori/drejtoria/komisariati)

TEPERSEKRET